

# UDHËTIMI nëpër INTERNET



# UDHËTIMI nëpër INTERNET

# UDHËTIMI nëpër INTERNET

## Udhëzues për mësimdhënës



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë*  
*Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju*  
*Ministry of Education, Science and Technology*

**Prishtinë, 2017**

## Udhëtimi nëpër internet

Autore: **Merita Januzi & Mimoza Hasani - Pllana**

Redaktorë: **Shqipe Z. Gashi**  
**Bislim Krasniqi**

Lektore: **Afërdita Kryeziu**

Kontribuesit:  
**Alush Istogu**  
**Faton Fetahu**  
**Veton Alihajdari**  
**Edi Puka**  
**Zana Kurtishi-Rudi**  
**Avni Rexha**  
**Habibe Buzuku**  
**Shkëndije Nagafci**  
**Shpresa Shala**  
**Bislim Krasniqi**  
**Minire Gashi**

Fotografia: **Norik Uka**  
Dizajni: **Leopard Cana**

Botues: **Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT)**

Të gjitha të drejtat për ribotim i përkasin MAShT dhe autoreve

<https://www.masht.rks-gov.net>

## Përmbajtja

Hyrja .....	7
-------------	---

### Kapitulli I

1.0. Informacione të përgjithshme .....	10
1.1. Rreziqet në internet .....	10
1.2. Roli i shkollës në parandalim të keqpërdorimit të TIK .....	12

### Kapitulli II

2.0. Mbrojtja e fëmijëve në internet nëpërmjet mësimdhënies dhe aktiviteteve tjera .....	12
2.1. Qasja kurrikulare, ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare e ekstrakurrikulare .....	
2.2. Alternativat e përdorimit të udhëzuesit sipas temave/ aktiviteteve/ këshillave të udhëzuesve për fëmijë .....	15
2.1.1. Mësimi .....	16
2.2.1. Kërkimi i informacionit .....	16

### Kapitulli III

3.0. Mundësitë e trajtimit të temave që ndërlidhen me mbrojtjen e fëmijëve në internet nëpërmjet mësimi me zgjedhje. ....	17
3.1. Qëllimi, njësitë tematike .....	17
3.2. Rezultatet e të nxënës të lëndës: Mbrojtja e fëmijëve nga rreziqet në internet .....	18
3.3. Udhëzime metodologjike .....	24
3.4. Udhëzime për vlerësim .....	26
3.5. Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore .....	26
3.6. Përfundim .....	27

# UDHËTIMI nëpër INTERNET

## Në vend të parathënies

*Ky botim është përgatitur nën përgjegjësinë e MASHT-it, në suazat e iniciativës nga stafi i të drejtave të njeriut/ fëmijës për krijimin e një platforme të qëndrueshme për mbrojtjen e fëmijëve në internet. Krahas përpjekjeve të MASHT-it për avancimin e përdorimit të përditshëm të teknologjisë informative në shkollat tona, synojmë edhe ndërgjegjësimin e komunitetit shkollor lidhur me përdorimin efektiv dhe të përgjegjshëm të internetit, për të shmangur keqpërdorimet dhe rreziqet e mundshme që vijnë nga ai.*

*Ky udhëzues dedikuar mësimeve do t'ju shërbejë atyre që të jenë mbrenda sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, duke zbatuar këshillat dhe rekomandimet relevante për rolin e tyre në këtë fushë, nëpërmjet procesit të mësimit dhe mësimit cilësor.*

*Derisa interneti u ofron nxënësve mundësi pafund për të rritur kapacitetet e dijes së tyre, ai po ashtu krijon edhe mundësi për përballje me rreziqe të shumta gjatë qëndrimit online. Andaj, ky material përmban informata të cilat u nevojiten mësimeve për realizimin e aktiviteteve brenda një ore mësimore, me qëllim që t'i aftësojnë nxënësit se si të jenë të sigurt në internet, si ta përdorin atë në mënyrë të dobishme dhe si të zhvillojnë mendim kritik për besueshmërinë e informatave që marrin gjatë përdorimit të internetit.*

*Për hartimin e këtij udhëzuesi kemi ndjekur parimet bazë të dokumenteve të fundit kurrikulare dhe arsimore në Kosovë, duke dashur që të ofrojmë modele të orëve mësimore në përputhshmëri me planprogramet hartuara nga MASHT.*

(Autoret)

## HYRJE

Me këtë libër (udhëzues) për mësimdhës duam që t`u ofrojmë atyre forma alternative të punës me qëllim të mbrojtjessë fëmijëve (nxënësve) në internet, nëpërmjet mësimdhënies e mësimnxënies, si procese kryesore në secilën fazë të arsimimit të fëmijëve të grupmohave të ndryshme.

E kemi parasysh se në ditët e sotme secila grupmoshë është përdoruese e internetit, por hulumtimet në vazhdimësi flasin për përdorim të përmasave të mëdhasidomos nga moshat e reja. E njëjta gjë po ndodh edhe në Kosovë dhe hulumtimet sa i përket shfrytëzimit të internetit (hulumtimet e FIT dhe të tjera) tregojnë se fëmijët tanë prijnë në raport me fëmijët e rajonit e të Evropës. Brenda këtij përdorimi masiv janë evidentuar edhe qëllimet dhe mënyrat e shfrytëzimit të internetit, dhe shihet se pjesa më e madhe e fëmijëve dhe e të rinjve internetin më shumë e përdorin për rrjete sociale, lojë e argëtim, se sa për qëllime arsimore e edukative, pa marrë fare në konsideratë mbrojtjen nga keqpërdorimet e lloj-llojshme që mund të ndodhin.

Shih për këtë, ne përmes pakossë udhëzuesve për mbrojtjen e fëmijëve në internet (brenda saj edhe ky udhëzues), synojmë bashkërendimin e veprimeve institucionale në parandalim të abuzimeve, duke orientuar nxënësit në përdorimin e internetit në mënyrë të drejtë, të përgjegjshme dhe të dobishme për zhvillimin e tyre.

Abuzimi, dhuna digjitale si edhe çdo formë tjetër e dhunës janë të sanksionuara me ligjet në fuqi, ashtu siç janë të mbrojtura edhe të drejtat e njeriut/ fëmijëve, të dhënat personale, privatësia etj. Prandaj, institucionet arsimore duhet të promovojnë politikat e mbrojtjes së secilit individ, veçanërisht fëmijëve, nëpërmjet zhvillimit të sistemit arsimor.

Arsimimi cilësor është shtylla kryesore që çon në ndërtimin e një kulture të shëndoshë të fëmijët tanë për përdorimin e internetit në mënyrë të duhur. Prandaj, përmes procesit arsimor duhet që të nxënësit ta kultivojmë komunikimin e mirë dhe ndjenjën e kontrollit mbi veprimet e tyre online, duke promovuar sjelljet e shëndosha dhe korrekte të komunikimit në internet, në çfarëdo relacioni.

Komunikimi nëpërmjet internetit tashmë tejkalon çdo formë tjetër komunikimi, por, si në familje, ashtu edhe në shkollë e gjetiu kërkohet përdorim racional dhe i përgjegjshëm, për të mos rënë pre e rreziqeve dhe e keqpërdorimeve të mundshme.



# UDHËTIMI nëpër INTERNET

Familja, shkolla dhe shoqëria janë përgjegjëse në edukimin e fëmijëve, në mënyrë që atyre mos t'u cënohet zhvillimi fizik dhe intelektual. Sa i përket internetit, ata duhet ta shfrytëzojnë atë për mësim, komunikim, lojë e argëtim, por njëkohësisht duhet t'i njohin edhe rregullat e komunikimit dhe të kenë kufij dhe rregulla mbi kohën e qëndrimit të tyre në internet, ngase përdorimi i tepërt dhe shmangia nga aktivitetet fizike i dëmton ata në aspektin shëndetësor. Kështu, përdorimi i tepërt dhe pa qëllim arsimor i dëmton ata edhe në aspektin intelektual, në kuptimin e rënies së rezultateve dhe ngecjes në arritje në mësim.

Gjithashtu, gjatë përdorimit të pakontrolluar të internetit fëmijët nuk e ruajnë privatësinë e tyre e të familjes dhe mund komunikojnë me të panjohur, duke iu ekspozuar rreziqeve të ndryshme, si: dhunës, trafikimit, grabitjes, ekspozimit ndaj përmbajtjeve pornografike dhe abuzimeve online.

Është përgjegjësi e jona e përbashkët që të kujdesemi për fëmijët dhe t'i mësojmë ata për sigurinë në internet, duke pasur parasysh se teknologjia po evoluon në vazhdimësi. Prandaj, ky udhëzues ka për qëllim që juve si mësimdhënës t'ju lehtësojë punën në edukimin e nxënësve rreth mbrojtjes në internet. Udhëzuesi është i organizuar në tre kapituj, ka ndërlidhje të plotë me udhëzuesit për fëmijë/ nxënës dhe si i tillë ka për qëllim:

- të sensibilizojë kuadrin arsimor për rreziqet në internet dhe për rolin e tyre në mbrojtjen gjatë përdorimit të tij;
- të lehtësojë përdorimin e udhëzuesve për fëmijë sipas niveleve arsimore;
- të shërbejë si model për orët mësimore sipas aktiviteteve dhe temave të caktuara.

Ne rekomandojmë këtë Udhëzues për mësimdhënës, duke synuar në përdorimin e duhur të internetit në shkollat e Republikës së Kosovës.



## Kapitulli I

### Informacione të përgjithshme

#### 1.1 Rreziqet në internet

Koha në të cilën po jetojmë i përket epokës së zhvillimeve të mëdha digjitale dhe për nxënës ofrohen mundësi pafund përfitimesh shumëdimensionale. Krahas përfitimeve, nxënësit e kësaj epoke mund të ballafaqohen edhe me rreziqe të shumta, të cilat burim kanë përdorimin e internetit.

Rreziqet potenciale për fëmijët e grupmoshave të arsimit parauniversitar që vijnë nga përdorimi i internetit janë:

- dhuna digjitale;
- komunikimi me të panjohur;
- publikimi i të dhënave personale;
- materialet me përmbajtje të papërshtashme;
- lojërat online.

Përshtatjen me zhvillimin e hovshëm të teknologjisë informative MASHT e parasheh në dokumentet kurrikulare dhe integrimin në epokën digjitale e vlerëson si një nga çështjet më të rëndësishme për ndërtimin e shoqërisë së dijes, ku përveç përfitimit të njohurive themelore, rol të rëndësishëm i jep zhvillimit dhe funksionalizimit të kompetencave digjitale. Megjithatë, këto dokumente vlerësojnë se krijimi i personaliteteve komplekse nuk arrihet vetëm me përfitimin e njohurive dhe shkathtësive digjitale.

#### 1.2 Roli i shkollës në parandalim të keqpërdorimit të TIK

Synimi i MASHT dhe partnerëve që mbështesin zhvillimin e arsimit në Kosovë është pajisja e të gjitha shkollave publike me kompjuter dhe lidhje interneti. Kurrikula, po ashtu, përmes lëndës së TIK-ut dhe lëndëve tjera ofron mundësi për organizimin e aktiviteteve shkollë, realizimi i të cilave nuk arrihet pa lidhje në internet.

Duke pasur parasysh faktin e qasjes së lehtë të fëmijëve në internet, institucionet arsimore duhet të mendojnë edhe për masat mbrojtëse ndaj tyre gjatë qëndrimit online për realizimin e aktiviteteve shkollë dhe jashtë shkollë.

# UDHËTIMI nëpër INTERNET

Mbrojtja e fëmijëve brenda shkollës dhe jashtë saj arrihet përmes edukimit të tyre për rreziqet që vijnë nga interneti, përmes çasjes së kufizuar në internet dhe në veçanti përmes rritjes së vetë përgjegjësisë së fëmijëve për t'u mbrojtur dhe për të qëndruar të sigurt në internet si brenda shkollës, ashtu edhe në ambiente tjera jashtë saj.

Nëse shkolla, konkretisht mësimmshënësi arrin t'i edukojë fëmijët për përdorim të internetit në mënyrë të dobishme dhe të përgjegjshme, atëherë sfidat për qëndrim të sigurt në internet do të kalohen më lehtë.



## Kapitulli II

### Informacione të përgjithshme

#### 2.0. Mbrojtja e fëmijëve në internet nëpërmjet mësimdhënies dhe aktiviteteve tjera

Përdorimi i teknologjisë informative është pjesë përbërëse e kurrikulës së re dhe e politikave arsimore në përgjithësi.

Kuadri arsimor dhe nxënësit duhet të promovojnë përdorimin e duhur të internetit në shkollë, duke pasur parasysh mundësitë për hulumtim dhe zhvillim në të gjitha fushat kurrikulare, që synojnë arritjen e gjashtë kompetencave kryesore të nxënësit (kompetencës së komunikimit dhe të shprehurit; kompetencës së menduarit; kompetencës për të mësuar; kompetencës për jetë, punë dhe mjedis; kompetencës personale dhe kompetencës qytetare).

#### 2.1. Qasja kurrikulare, ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare

Lënda e TIK-ut në suazat e mësimi të rregullt, përveç përmbajtjeve mësimore mbi pajisjet kompjuterike, mënyrat e përdorimit, programimin, rrjetet etj., përmban edhe komponentën e edukimit mbi rreziqet nga keqpërdorimi i pajisjeve elektronike dhe abuzimi me internetin, në mënyrë që pjesa e arsimimit të shkojë paralel me edukimin e mirëfilltë, duke i kontribuar kompetencave të synuara, veçanërisht kompetencës së komunikimit dhe të shprehurit, kompetencës personale dhe asaj qytetare.

Kështu, duhet të kontribuojmë që secili fëmijë të rritet shëndetshëm dhe të bëhet i përgjegjshëm. Prandaj, puna e përditshme e kuadrit arsimor duhet të reflektojë cilësi të duhur të procesit edukativo-arsimor, për të siguruar që fëmijët në nivele të caktuara arsimore t'i arrijnë shkathtësitë dhe rezultatet e duhura brenda potencialeve dhe mundësive intelektuale që i kanë ata, duke qenë të mbrojtur njëkohësisht.

Në secilën fushë kurrikulare (Gjuhët dhe komunikimi, Artet, Matematika, Shkencat natyrore, Shoqëria dhe mjedisi, Edukata fizike, Sportet dhe shëndeti, Jeta dhe puna), si dhe në çdo lëndë mësimore mund të përdoret interneti në arritjen e rezultateve të nxënësit nëpërmjet hulumtimeve, kërkimeve, prezantimeve dhe mësimave


# UDHËTIMI nëpër INTERNET

online. Atëherë, duke e parë perspektivën ndërkurrikulare, secili mësuesdhënësi i cilësdo fushë, fillimishtduhet t'i njohë rregullat e mbrojtjes gjatë përdorimit të internetit dhe gjatë procesit të mësuesdhënies dhe mësuesnxënies, duhet t'i zbatojë ato, duke i promovuar dhe transmetuar në përditshmërit e nxënësit, në mënyrë që ndër breza të zhvillohet kultura e shëndoshë e përdorimit të internetit në çdo relacion komunikimi, mësimi, etj. Më tej, nga mësuesdhënësi kërkohet që në fazën e planifikimit të analizojë rezultatet e fushës, rezultatet e lëndës, temat dhe njësitet mësuesore dhe të shohë se me cilat çështje ndërkurrikulare ndërlidhen. Në këtë mënyrë sigurohet mësuesdhënie e integruar dhe trajtim sa më i mirë i çështjeve kryesore, si:

- Përdorimi i TIK-ut në mënyrë të dobishme dhe të përgjegjshme;
- Siguria në internet/ mbrojtja nga rreziqet online;
- Vetëdijësimi për ndikimet negative nga keqpërdorimi i internetit.

Tema e mbrojtjes nga rreziqet online mund të adresohet brenda shkollave tona edhe përmes aktiviteteve dhe veprimtarive jashtëkurrikulare, duke realizuar projekte e programe vetëdijësuese, me qëllim të ndërgjegjësimit të komunitetit shkollor për rreziqet e shumta që vijnë nga keqpërdorimi i internetit. Mirëpo, ekziston mundësia dhe ka nevojë që mbrojtja në internet të ofrohet edhe si mësues zgjedhor.

Kështu, ky udhëzues sugjerohet të përdoret për ta lehtësuar zbatimin e udhëzuesve për fëmijë/nxënës dhe alternativat e përdorimit janë të hapura. Ndërkohë, në vazhdim do të japim propozimet tona për mundësitë e zbatimit të udhëzuesve, bazuar në temat dhe aktivitetet e realizuara në udhëzuesit për klasat 3-5 dhe klasat 6-9. Gjithashtu, aktivitete të ngjashme mund të realizoni dhe t'i përshtatni ato edhe për klasat parafillore, për klasën e parë (1), e deri në klasën e tretë (3).







# UDHËTIMI nëpër INTERNET

## 2.2. Alternativat e përdorimit të udhëzuesit sipas temave/ aktiviteteve/ këshillave

Në udhëzuesit për fëmijë/nxënës kemitreguar qëllimet e përdorimit të internetit dhe sipas tyre kemi vazhduar me udhëzime e aktivitete.

U kemi thënë se:

### Qëllimet mund të jenë:

- mësimi;
- kërkimi i informacionit;
- shoqërimi (rrjetet sociale);
- komunikimi;
- argëtimi etj.



Duke i deshifruar qëllimet pozitive dhe mundësitë që na i ofron interneti në jetën e përditshme dhe gjatë mësimit, kemi sugjeruar aktivitete që mund të realizohen nga fëmijët në shtëpi, nën përkujdesje të prindit, apo në klasë me përkrahjen e mësimeve. Më tej kemi folë për rreziqet në internet, ngase në ditët e sotme të epokës digjitale, si pasojë e keqpërdorimit të internetit, kemi mjaft indikacione për dhunë në mes të moshatarëve dhe në nivele të tjera, por edhe rreziqe tjera nga grupe e rrjete kriminale, dhe për pasojë mund të vie deri te: grabitja, kidnapimi, trafikimi dhe eksploatimi në forma të ndryshme.

Institucionet shtetërore duhet të kenë qasje proaktive ndaj dukurive negative që e atakojnë shoqërinë, për të qenë brenda sistemit të mbrojtjes së qytetarëve vet. Kështu, brenda këtij sistemi, institucionet arsimore me mandatin e tyre ligjor dhe duke iu referuar qëllimeve të përgjithshme (sipas ligjeve në fuqi dhe instrumenteve ndërkombëtare), duhet të ushtrojnë rolin e tyre në edukim e arsimim cilësor, i cili duhet të promovojë vlera të qytetërimit demokratik, ku marrëdhëniet ndërnjerëzore sigurojnë ambiente humane, miqësore e të sigurta për të gjithë.

Kështu, duke u ndërlidhur me udhëzuesit për fëmijë/nxënës, në vijim do t'i paraqesim temat dhe aktivitetet që mund t'iu adresohen programeve të caktuara lëndore, gjithnjë duke pasur parasysh rezultatet e të nxënësve karshi kompetencave të synuara nëpër fusha kurrikulare dhe nivele arsimore.

### 2.2.1. Mësimi

Te tema “Mësimi” ne kemi vendosur aktivitete, si: kërkoni në Google, p.sh: “Si ushqehet kafsha që ju pëlqen?” (shih Udhëzuesin për klasat 3-5 ) dhe “Kërko në internet krijimtarinë e autor-it/es që të pëlqen!” (shih Udhëzuesin për klasat 6-9), përmes të cilave synojmë nxitjen e përdorimit të internetit për qëllime arsimore.

Aktiviteti i parë mund të realizohet te fusha: Shkencat natyrore, përmes shtjellimit të ndonjë teme specifike nga Njeriu e natyra ose Biologjia. Por, diçka e tillë, gjithashtu mund të realizohet edhe te fusha: Gjuha dhe komunikimi, ku fëmijët mund të hulumtojnë dhe të inspirohen që të shkruajnë ndonjë tregim a poezi për kafshën që u pëlqen (kuptohet që rezultatet e synuara duhet t'i kontribuojnë lëndës).

Në tabelën e planifikimit, në të cilën e deshifroni planifikimin e orës mësimore, e përcaktoni: lëndën, temën mësimore, rezultatet e të nxënit për lëndë, njësinë mësimore dhe rezultatet e të nxënit sipas kompetencave.

### 2.2.2. Kërkimi i informacionit

Edhe kërkimi i informacionit nëpërmjet internetit bëhet për secilën fushë kurrikulare, por duke pasur parasysh që nxënësit duhet të orientohen drejt dhe të mësojnë rregullat e kërkimit të sigurt. Një gjë e tillë kërkohet edhe përmes aktiviteteve të sugjeruara tek udhëzuesit për fëmijë/nxënës.

Për aktivitetin: **“Kërko në internet krijimtarinë e autor-it/es që të pëlqen!”** (shih Udhëzuesin për klasat 6-9), karshi temës/njësisë mësimore, rezultateve, etj., mësimdhënësi sigurisht që nxit hulumtimin e literaturës online dhe informatave tjera në linqet relevante për temën/njësinë e caktuar.

Në udhëzuesit për fëmijë/nxënës (për klasat 3-5 dhe për klasat 6-9) kemi dhënë detaje edhe për aspektet e shoqërimit, komunikimit dhe argëtimit, të cilat mund t'i merrni parasysh. Mirëpo, duke qenë se udhëzuesi synon adresimin e duhur të komponentës së mbrojtjes gjatë përdorimit të internetit dhe kjo komponentë duhet të jetë pjesë integrale e edukimit dhe e arsimimit të fëmijëve/nxënësve, sugjerojmë tema që ekskluzivisht trajtojnë mbrojtjen nga rreziqet në internet. Kështu, krahas rregullave dhe këshillave që u kemi ofruar tek udhëzuesit tjerë, po i deshifrojmë edhe mundësitë që ofrojnë dokumentet tona kurrikulare në trajtimin e tyre përgjatë shkollimit të obligueshëm. Kjo tematikë posedon hapësirë të mjaftueshme të trajtimit brenda fushave kurrikulare edhe me kurrikulën me zgjedhje.



## Kapitulli III

### 3.0. Mundësitë e trajtimit të temave që ndërlidhen me mbrojtjen e fëmijëve në internet nëpërmjet mësimit me zgjedhje

Tema e mbrojtjes së fëmijëve në internet duhet të trajtohet në nivelin e duhur, kur kemi parasysh zhvillimet e hovshme të teknologjisë dhe mundësitë e keqpërdorimit dhe kanosjen ndaj rreziqeve të shumta. Duke pasur parasysh se dhuna digjitale dhe abuzimi me internetin ndikojnë negativisht në zhvillimin e fëmijëve/nxënësve, mësimgdhënësit në bashkëpunim me ta mund të zgjedhin (sipas U.A. dhe udhëzuesit) që ta trajtojnë këtë temë të ndjeshme në realitetin e kohës digjitale. Kjo temë kaq e ndjeshme në realitetin e sotëm shoqëror lipset të trajtohet me prioritet, në të mirë të interesit nacional dhe global.

#### 3.1. Qëllimi:

Lënda: “Mbrojtja e fëmijëve në internet” duhet të synojë zhvillimin e personalitetit të fëmijës/nxënësit mbi bazën e vlerave dhe të kulturës së shëndoshë të përdorimit të internetit, duke pretenduar:

- orientimin e nxënësve në përdorimin e duhur të internetit për qëllime arsimore dhe aktivitete tjera kreative e argëtuese, dhe sjelljen në mënyrë humane dhe të përgjegjshme;
- vetëdijësimin mbi rreziqet në internet;
- promovimin e sjelljeve të shëndosha dhe shmangien e konflikteve/dhunës digjitale;
- shmangien nga abuzimet, joshjet dhe mashtrimet e llojeve të tjera.

Qëllimi i kësaj lënde u shkon përshtati disa koncepteve në fusha të ndryshme kurrikulare, si: Shoqëria e mjedisi (Individi; Grupet dhe marrëdhëniet shoqërore; Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë; Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm), Edukata fizike, sportet dhe shëndeti (Mirëqenie e plotë fizike, psikike, emocionale dhe sociale; Edukimi mbi mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm) dhe Jeta dhe puna (Teknologji, duke përfshirë TIK-un; Edukim për zhvillim të qëndrueshëm) etj.

Njësitë tematike:

- Mësimi
- Kërkimi i informacionit
- Komunikimi
- Loja
- Argëtimi
- Dhuna digjitale
- Komunikimi me të panjohur
- Trafikimi me njerëz
- Mbrojtja e privatësisë- të dhënat personale
- Fjalëkalimi
- Hulumtim mbi ndikimet negative nga keqpërdorimi i internetit
- Fushatë vetëdijësuese: “Përdore internetin në mënyrë të sigurt e të përgjegjshme!”

### 3.2. Rezultatet e të nxënit në lëndën: Mbrojtja e fëmijëve nga rreziqet në internet

*(Te kjo tabelë jepet shembulli i deshifrimit të temave, rezultateve, krahas qëllimit. Ndërkaq, mësimdhënësit mund të nxjerrin/adaptojnë ngjashëm temat dhe rezultatet për cilëndo klasë dhe grupmoshë, duke ndjekur formatet për plane vjetore dhe mujore nga udhëzuesi për kurrikulë me zgjedhje.)*

# UDHËTIMI nëpër INTERNET

Qëllimi	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT)	Kompetencat
Promovimi i përdorimit të internetit në mënyrë të dobishme, të shëndetshme dhe të përgjegjshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimi</li> <li>- Kërkimi i informacionit</li> <li>- Komunikimi</li> <li>- Loja</li> <li>- Argëtimi</li> </ul>	<p>Përdor internetin për qëllime mësimore në fusha dhe lëndë të ndryshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson ruajtjen e shëndetit fizik dhe emocional gjatë situatave të ndryshme të përdorimit të internetit.</li> <li>- Identifikon dhe demonstroi rregullat e komunikimit në internet.</li> <li>- Kontrollon kohën e përdorimit të internetit.</li> <li>- Njeh dhe demonstroi rregullat dhe përparësitë e përdorimit të lojërave të sigurta.</li> <li>- Demonstroi aftësi kreative dhe argëtuese.</li> <li>- Njeh dhe kupton elementet negative që e çenojnë lojën dhe argëtimin.</li> </ul>	<p>Kompetencë e të mësuarit (Nxënës i suksesshëm):</p> <p>Zotërimi i mirëfilltë i leximit, i shkrimit, i matematikës, i shkencës, i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Identifikimi dhe përpunimi i informatave në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Komunikues efektiv):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komunikimi nëpërmjet teknologjisë informative.</li> <li>- Respektimi i rregullave të komunikimit.</li> <li>- Dhënia dhe pranimi i informatës kthyesë në mënyrë konstruktive.</li> <li>- Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.</li> </ul>

<p>Mbrojtja nga keqpërdorimi i internetit dhe rreziqet online</p>	<p>Dhuna digjitale</p> <p>Komunikimi me të panjohur</p> <p>Trafikimi me njerëz</p> <p>Mbrojtja e privatësisë - të dhënat personale</p> <p>Fjalëkalimi</p> <p>Lojërat online</p>	<p>Njeh shenjat e dhunës digjitale.</p> <p>Liston elementet e dhunës digjitale.</p> <p>Shpreh mendime të qarta mbi mundësitë e shmangies nga dhuna digjitale.</p> <p>Njeh dhe tregon aftësi të shmangies nga komunikimi me të panjohur.</p> <p>Liston rreziqet nga komunikimi me të panjohur.</p> <p>Njeh dhe liston elementet e trafikimit me njerëz.</p> <p>Përshkruan si mund të ndihet një viktimë trafikimi.</p> <p>Përshkruan dhe komenton pasojat e trafikimit me njerëz.</p> <p>Njeh rregullat dhe termat e privatësisë.</p> <p>Njeh mekanizmat për mbrojtjen e të dhënave personale (ligjin, institucionet).</p> <p>E vlerëson fjalëkalimin si diçka tejet personale.</p> <p>Njeh mundësitë dhe dobitë nga lojërat online.</p> <p>Njeh dhe liston rreziqet nga lojërat online.</p>	<p>Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (Kontribues produktiv)</p> <p>o Zotërim i aftësive për menaxhim të konflikteve dhe vlerësim të rreziqeve.</p> <p>o Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme.</p> <p>Kompetenca qytetare (Qytetar i përgjegjshëm):</p> <p>o Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.</p> <p>o Mirëkuptim dhe respektim i dallimeve ndërmjet njerëzve.</p> <p>o Tolerancë dhe respekt për të tjerët.</p> <p>o Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.</p> <p>o Përkrahje dhe inicimi ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.</p>
---	---	---	---

# UDHËTIMI nëpër INTERNET

<p>Vetëdijesimi për ndikimet negative nga keqpërdorimi i internetit</p>	<p>Hulumtim mbi ndikimet negative nga keqpërdorimi i internetit</p> <p>Fushatë vetëdijësuese: “Përdore internetin në mënyrë të sigurt e të përgjegjshme”</p>	<p>Njih instrumentet e hulumtimit.</p> <p>Njih format e organizimit të fushatave.</p> <p>Liston qëllimet e fushatës.</p> <p>Përshkruan aktivitetet që mund të ndikojnë në vetëdijësim.</p>	<p>Kompetenca qytetare (Qytetar i përgjegjshëm)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.</li> <li>- Mirëkuptim dhe respektim i dallimeve ndërmjet njerëzve.</li> <li>- Tolerancë dhe respekt për të tjerët.</li> <li>- Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.</li> <li>- Përkrahje dhe inicimi ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.</li> </ul>
---	--	--	--

## Model i planit vjetor për kurrikulën me zgjedhje

Plani vjetor i temave mësimore për Kurrikulën me Zgjedhje ( KZ)							
Viti shkollor 2017/2018				Klasa:			
Emri i lëndës /projektit/modulit: MBROJTJA E FËMIJËVE NGA RREZIQET NË INTERNET							
Mësimdhënës-i/ja:							
Emri i lëndës /pro-jektit/modulit	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA NËPËR MUAJ						Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompe-tencat kryesore të shkallës
	PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)		PERIUDHA (III)		
	Shtator - Tetor	Nëntor - Dhjetor	Janar - Shkurt	Mars – Prill ( java I)	Prill - Maj	Qershor	
MBROJTJA E FËMIJËVE NGA RREZIQET NË INTERNET	Promovimi i përdorimit të internetit në mënyrë të dobishme	Përdorimi internetit në mënyrë të dobishme, të shën-detshme dhe të përg-jegjshme	Mbrojtja nga keqpër-dorimi i in-ternetit dhe nga rreziqet online	Mbrojtja nga keqpër-dorimi i in-ternetit dhe nga rreziqet online	Vetëdijësimi për ndikimet negative nga keqpër-dorimi i internetit	Vetëdijësimi për ndikimet negative nga keqpër-dorimi i internetit	Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm III(KB-2-të 1, 5, 6) ( KB-3-të, 6,9)  Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv I(KB-2-të 3,5,7) ( KB-3-të, 5,8,9)  Kompetenca e të menduarit – Men-dimtar kreativ II(KB-2-të, 4) (KB-3-të, 2)  Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribuues pro-duktiv IV (KB-2-të, 1,6) ( KB-3-të, 1,3,6 )  Kompetenca per-sonale – Individ i shëndoshë V(KB-2-të, 5) ( KB-3-të, 1,4 ) Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm VI (KB-2-të, 4,5,8) ( KB-3-të, 6,7,8,9)

# UDHËTIMI nëpër INTERNET

## Model i planit dymujor nga kurrikula me zgjedhje

Plani dymujor: SHTATOR - TETOR				Kurrikula me Zgjedhje ( KZ)				Klasa :	
Lënda /projekti /moduli: MBROJTJA E FËMIJËVE NGA RREZIQET NË INTERNET									
MUAJ	Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet	Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës
Shtator	Promovimi i përdorimit të internetit në mënyrë të dobishme	<b>Perdor</b> internetin për qëllime mësimore në fusha dhe lëndë të ndryshme.  <b>Vlerëson</b> ruajtjen e shëndetit fizik dhe emocional gjatë situatave të ndryshme të përdorimit të internetit..	<b>Mësimi</b>  <b>Llojet e mësimimit</b>  <b>Kërkimi i informacionit</b>	1	Demonstrimi dhe mënyra e ekzekutimit të operacioneve	Aktivitet në klasë  Vlerësimi i angazhimit të nxënësit	Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë	Teksti, revistat shkencore, vizatime të gatshme, interneti, sllajde.	Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm III (KB-2-të 1, 5, 6) ( KB-3-të, 6,9)  Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv I (KB-2-të 3,5,7) ( KB-3-të, 5,8,9)  Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ II(KB-2-të, 4) ( KB-3-të, 2)
				1					
				1					
				1	Puna individuale dhe grupe .	Vlerësimi në punë grupe			
				1					
				1					
				1	Demonstrimi individual	Vlerësimi formues			
1	Demonstrimi grupor								
Tetor	Promovimi i përdorimit të internetit në mënyrë të dobishme	<b>Identifikon</b> dhe demonstroi rregullat e komunikimit në internet.  <b>Kontrollon</b> kohën e përdorimit të internetit .  <b>Njeh</b> dhe demonstroi rregullat dhe përparësitë e përdorimit të lojërave të sigurta.	<b>Komunikimi</b>  <b>Rregullat e komunikimit</b>  <b>Koha e përdorimit në internet</b>  <b>Loja Rregullat e lojës</b>	1	Demonstrimi dhe mënyra e ekzekutimit të operacioneve	Aktivitet në klasë  Vlerësimi i angazhimit të nxënësit	Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë	Teksti, revistat shkencore, vizatime të gatshme, internet, sllajde.	Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribuues produktiv IV (KB-2-të, 1,6) ( KB-3-të, 1,3,6 )  Kompetenca personale – Individ i shëndoshë V (KB-2-të, 5) ( KB-3-të, 1,4 )  Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm VI (KB-2-të, 4,5,8) ( KB-3-të, 6,7,8,9 )
				1					
				1					
				1	Puna individuale dhe grupe .	Vlerësimi në punë grupe			
				1					
				1					
				1	Demonstrimi individual	Vlerësimi formues			
				1					



### 3.3. Udhëzime metodologjike

Brenda filozofisë dhe parimeve të dokumenteve kurrikulare (KKK dhe KB-ve) duhet të jenë edhe metodat e realizimit të lëndës, gjithnjë duke pasur parasysh rezultatet e të nxënit për kompetencat për shkallë (RNK), rezultatet e të nxënit për fushën (RNF) dhe rezultatet e të nxënit për lëndën (RNL).

Lënda: “Mbrojtja e fëmijëve në internet” duhet t’i aftësojë nxënësit për përdorim të internetit në suaza të rregullave për mbrojtjen nga keqpërdorimet dhe rreziqet e shumta. Mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të bashkëveprojnë për ta krijuar dhe kultivuar një kulturë të shëndoshë të komunikimit dhe të punës me internet, duke praktikuar metoda, forma e teknika të lloj-llojshme në funksion të rezultateve të synuara dhe kompetencave në cilëndo shkallë kurrikulare.

Duke pasur parasysh se përdorimi i internetit është pjesë e përditshmërisë së nxënësve dhe mësimdhënësve, mund të ofrohen alternativa të ndryshme të informimit, mësimi dhe përvetësimit të njohurive mbi mënyrat e mbrojtjes në internet. Kështu, mund të realizohen aktivitete të caktuara, projekte dhe detyra konkrete të udhëhequra nga mësimdhënësi, duke përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të cilat u shërbejnë nxënësve për arritjen e rezultateve të dëshiruara.

# UDHËTIMI nëpër INTERNET



### 3.4. Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i mbledhjes së informatave dhe i nxjerrjes së gjykimeve për arritshmërinë ose performancën e nxënësve.

Sigurisht që në qendër të preokupimit tonë është të nxënësve të suksesshëm dhe ushtrimi i njohurive në praktikë nga ana e nxënësve. Prandaj, për ta vlerësuar atë duhet të bëjmë matje dhe vlerësim të suksesit në vazhdimësi, sipas llojeve të vlerësimit të përcaktuara me KKK, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm.

Në dokumentet kurrikulare thuhet: “Lënda, moduli a projekti në momentin e përzgjedhjes nga nxënësit dhe përcaktimit definitiv nga shkolla, respektivisht komuna, bëhet e detyrueshme dhe merr statusin e barabartë me të gjitha lëndët e tjera që janë përcaktuar në dokumentet kurrikulare.

Gjithashtu, vlerësimi i nxënësve që ndjekin programet mësimore të lëndëve, moduleve a projekteve që dalin nga Kurrikula me zgjedhje bëhet me metodologji dhe procedura si të lëndëvëmësimore të përcaktuara në dokumentet kurrikulare, dhe me procedura që përcaktohen me akte nënligjore/udhëzim administrativ.

Dallimi është se lënda, moduli a projekti me zgjedhjenuk është pjesë e vlerësimit të jashtëm, por kontribuese e zhvillimit të kompetencave.”

### 3.5. Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në kuadër të lëndës me zgjedhje: “Mbrojtja e fëmijëve në internet”, duke synuar rezultatet e caktuara, përveç teksteve dhe burimeve shkollore, përdoren edhe mjete e burime të tjera vizuale dhe audovizuale, si: fotografi, ilustrime, video, dokumentarë, linqe adekuate, persona burimorë (profesionistë nga fushat specifike që trajtohen brenda lëndës), tekste alternative, raporte nga hulumtimet e ndryshme, raste studimi etj.

Të gjitha këto, dhe jo vetëm këto, mund të përdoren në mjedis mësimor (në kushte të klasës, në ambiente tjera të shkollës, në kushte shtëpie apo në ambiente tjera, në rast të vizitave në institucione të ndryshme).

## 3.6. Përfundim

Të nderuar mësimdhënës,

tek udhëzuesit dedikuar nxënësve kemi konsideruar se në fund fare kur nxënësit mësojnë ta përdorin internetin në mënyrë të dobishme dhe të përgjegjshme, ata do të dalin të suksesshëm në mësimet dhe në shkollimin e mëtejshëm, ngase duke ndjekur mësimet tuaja dhe këshillat tona ata do të arrijnë rezultatet në mësimet dhe do të kujdesen në vazhdimësi për ta mbrojtur veten dhe të tjerët nga keqpërdorimet në internet, ngase abuzimet në internet çënojnë sigurinë e fëmijëve dhe shoqërinë në përgjithësi.

Prandaj, ne synojmë që institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese, me cilësinë e shërbimeve të veta të ndikojnë në parandalimin e rreziqeve dhe në zhvillimin e duhur të brezave të rinj.

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

004:37(075.2) (035)

**Januzi, Merita**

**Udhëtimi nëpër internet : udhëzues për mësimdhënës / Merita Januzi, Mimoza Hasani Pllana. – Prishtinë : MASHT, 2017. – 28 : ilustr. me ngjyra; 21 cm.**

**1. Pllana Hasani, Mimoza**

**ISBN-978-9951-16-109-1**

# UDHËTIMI nëpër INTERNET



## Udhëzues për mësimdhënës



### Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministarstva za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju  
Ministry of Education, Science and Technology*

Të gjitha të drejtat për ribotim i përkasin MASHT dhe autoreve



9 789951 161091